

UDHËZIM
Nr. 20, datë 22.6.2023

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 20.2.2023, “PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT FINANCIAR TË VLERËS SË PLOTË TË PROJEKTIT NË PËRPUTHJE ME SPECIFIKAT E SEKTORIT, MBI BAZËN E TË CILIT PËRCAKTOHET MËNYRA DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT PUBLIK”

Në përputhje me nenin 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me përmbajtje si vijon:

“Për projektet komplekse të cilat prekin disa sektorë dhe kanë në përbërje shumë projekte pikësore që i përkasin sektorëve të ndryshëm, kufiri financiar është 700,000,000 lekë për sektorët ‘Digjital’, ‘Social’, ‘Zhvillimi Ekonomik’ dhe ‘Mjedisi’”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj